



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1262/11 Prot.

Elbasan më 25.11.2021

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD


Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.90 datë 19.11.2021 “Për miratimin e marrëveshjes ndërvendore për krijimin e një personi juridik të përbashkët”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Majlinda Perriu

1262
19.11.2021
REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK



REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt. 19.11.2021

Nr. 6121/prot

Nr.90dt. 19.11. 2021

**“PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRVENDORE
PËR KRIJIMIN E NJË PERSONI JURIDIK TË PËRBASHKËT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 14, pika 3 e 5, nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, gërma (gj) të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Librazhd, duke vlerësuar nevojën që nëpërmjet aktivitetit të ushtruar nga një person juridik i pavarur, i përbashkët me të gjitha njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan, të përmbushë funksionin dhe shërbimin vendor për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, në kushtet kur nuk vlerësohet efçente asnjë mënyrë tjetër për ushtrimin e këtij funksioni, Keshilli bashkiak në mbledhjen e tij të datës 19.11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI

1. Të miratojë krijimin e një personi juridik të përbashkët, që do tu shërbejë të gjitha njësite bazë të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan për ushtrimin e funksionit të mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
2. Të miratoje marrëveshjen ndërvendore midis shtatë bashkive të qarkut Elbasan për krijimin e një personi juridik të përbashkët në formën e një shoqërie tregtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**Sek.i Keshillit
Elson Malluta**

**KRYETARI I KËSHILLIT
Shefki Bahiti**

